

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT TË PROVIMIT TË MATURËS NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, GUSHT 2020

1. Nxënësi/ nxënësja* merr **1 pikë** nëse cekë dy elemente si në vijim: rritja e numrit të popullatës, ndryshimet klimatike, qytetet e mëdha, ndotjet gjithnjë e më të shumta, ndotja e ujërave sipërfaqësor.
2. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: 21%.
3. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Sasia më e madhe e ujit është e nevojshme për prodhimin e 1 kg mishit të lopës./ Për prodhimin e mishit të lopës./ Për mishin e lopës/ bagëtisë.
4. Është rrethuar numri 3: 30000 njerëz – **1 pikë**
5. Nxënësi merr **1 pikë** nëse rrethon P dhe shkruan argumentimin: Në vendet e zhvilluara konsumimi kalon 500 l/për banorë/ në ditë, kurse në vendet në zhvillim një person mesatarisht konsumon 10 l ujë në ditë. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*.
Vërejtje: Pranohet edhe nëse nxënësi nuk ka rrethuar as S dhe as P, por që nga argumentimi është e qartë se konstatimi është i saktë.
6. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Për kujdesin e duhur të të sëmurëve në spital gjatë një dite, nevojiten nga 240 deri në 400 l ujë./ 250 – 400 litra.
7. Nxënësi merr **1 pikë** për një përgjigje plotësisht të saktë:

Në Greqinë e Lashtë shfaqjet sportive dhe teatrore kishin prapavijë fetare.	S	P
Lojërat sportive shkaktojnë një katarsis tek shikuesit.	S	P
Në shfaqjet tradicionale aktorët nuk e dinë rezultatin përfundimtar.	S	P

8. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Teatri e ka skenarin e paracaktuar, ndërsa sporti nuk e ka. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*
9. Gjithsej **2 pikë**:
Nxënësi merr **1 pikë** për një përgjigje të pjesshme, përkatësisht nëse përgjigjja bazohet vetëm në dallimin e modernes, p.sh.: Nuk dihet se si do të përfundojë shfaqja./Të gjithë aktorët nuk janë profesionist. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*.

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

Nxënësi merr **2 pikë** për një përgjigje plotësisht të saktë dhe me stil, p.sh. Në shfaqjen e improvizuar tre aktorë profesionistë luajnë Hamletin, Ofelinë dhe Gertrudën para gjykatësve të vërtetë, avokatëve forenzikëve dhe dëshmojnë pafajësinë e tyre ose fajin e atij tjetri, kurse porota është nga radhët e publikut./ Shfaqja është moderne sepse në të përveç tre aktorëve profesionistë marrin pjesë edhe gjykatësit e vërtetë dhe avokatët. Aktorët e vërtetë para tyre dëshmojnë kush është i pafajshëm, dhe kush është fajtor dhe nuk dihet çfarë do të vendosë porota. *(dhe përgjigje të tjera të sakta).*

10. Gjithsej 2 pikë:

Nxënësi merr **1 pikë** për një përgjigje të pjesshme, përkatësisht nëse përgjigjja bazohet vetëm në dallimin, p.sh.: Sot ekzistojnë shfaqje të luftimeve të cilat vetëm në dukje na përkujtojnë në ngjarje sportive. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

Nxënësi merr **2 pikë** për një përgjigje plotësisht të saktë dhe me stil, p.sh.: Në disa vende keçerët bartin maskat dhe kanë një sjellje në pajtim me maskën – demonin, dreqin, shenjtin... dhe publiku u brohorit atyre, dhe jo njerëzve të cilët e fshehin identitetin e tyre prapa maskave. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

11. Është rrethuar numri 3: publicistik – 1 pikë

12. Gjithsej 2 pikë – nxënësi merr 2 pikë për përgjigje plotësisht të saktë:

*Juda Makabe – Me hike unë n'luftë!... Shpejt, Jonathas,
Antigona – S'linda për urrejtje, por për dashuri.
Iliada – Këndo, hyjneshë, mëninë e Akil Pelidit
Çeta e profetëve – e tepërt*

Nxënësi merr **1 pikë** për 2 ose 3 përgjigje të sakta.

Nxënësi merr **0 pikë** për 1 ose asnjë përgjigje të saktë.

13. Nxënësi merr 1 pikë nëse ka shkruar saktë titullit e veprës dhe emrin dhe mbiemrin e autorit të saj:

Bardha e Tamalit; Pashko Vasa

14. Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan: Tema kryesore në fragmentin e dhënë është vrasja e Bardhës.

15. Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan: Vjehrra

16. A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan një paragraf rrëfyes nga fragmenti, p.sh.: *Sapo u ngrit më këmbë mbi dysheme, iu afrua Bardhës që të sigurohej se po flinte; pastaj pa derën dhe pa se ishte mbyllur brenda. (dhe përgjigje të tjera të sakta).*

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan një paragraf përshkrues nga fragmenti, p.sh.: *Fytyra e gruas së re vetëtinte nga bukuria; një hije e lehtë melankolie u jepte tipareve të saj diçka poetike dhe hyjnore.... (dhe përgjigje të tjera të sakta).*

17. Është rrethuar numri 2: frazeologjizëm – **1 pikë**

18. A) Nxënësi merr **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

1. d.m.th.
2. etj.
3. KB

Nxënësi merr **1 pikë** për dy përgjigje të sakta.

Nxënësi merr **0 pikë** për një apo asnjë përgjigje të saktë.

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan:

pesëqind e pesëmbëdhjetë

19. Gjithsej **2 pikë** – nxënësi merr nga 1 pikë për përgjigje të saktë:

gjinia letrare – gjinia lirike

lloji letrar – vjershë lirike

20. Është rrethuar numri 1: *Këngët e Ringjalljes* – **1 pikë**

21. A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse rrethon numrin 1. Thuaja këngës

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse argumenton përgjigjen nën A, p.sh.: *Tonet thirrmore që përshkojnë të katër strofat e poezisë, përshkallëzojnë idenë dhe ndjenjën nga thirrja për të kënduar, Thuaj këngës deri te dëshira – thirrje, Qeshu! (dhe përgjigje të tjera të sakta).*

Vërejtje: Nëse nuk është përgjigja e saktë nën A, përgjigja nën B nuk pranohet edhe nëse është e saktë.

22. Është rrethuar numri 1: *Tingëllimë* – **1 pikë**

23. Gjithsej 3 pikë:

A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse rrethon PO

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse argumenton vetëm dëshirën e poetit, p.sh.: Dëshira e poetit është për të dalë nga e përditshmja dhe pesimizmi duke dashur ritmin marramendës të rinisë. *(dhe përgjigje të tjera të sakta).*

Nxënësi merr **2 pikë** nëse përveç dëshirës së poetit tregon edhe detajet që e portretizojnë rininë, p.sh.: Dëshira e poetit është për të dalë nga e përditshmja dhe pesimizmi duke dashur ritmin marramendës të rinisë, ndërsa detajet janë gëzimi dhe vrulli. *(dhe përgjigje të tjera të sakta).*

24. Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan: *e puthitur/AABB*

25. Gjithsej 3 pikë:

A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse përshkruan (nënvizon ose rrethon) figurën stilistike e cila nuk i përket vargut të dhënë: *O Hamlet, mos fol më;*

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse dallon dhe emëron vetëm figurën stilistike të vargut i cili nuk i përket figurave tjera stilistike që kanë tri vargjet tjera duke thënë se vargu i përshkruar është apostrof.

Nxënësi merr **2 pikë** nëse shkruan: *O Hamlet, mos fol më* është apostrof kurse tjerat janë metafora.

Vërejtje: Nëse nuk është përgjigja e saktë nën A, përgjigja nën B nuk pranohet edhe nëse është e saktë.

26. Gjithsej 3 pikë – nxënësi merr nga *1 pikë* nëse pranë emrit të personazhit shkruan saktë titullin e veprës në të cilën paraqitet:

Maria Kardana – *I huaji (1 pikë)*

Tanusha – *Cikli i këngëve të kreshnikëve (1 pikë)*

Beatriçja – *Komedia hyjnore (1 pikë)*

27. Është rrethuar numri 3: *taman* – 1 pikë

28. Nxënësi merr 2 pikë për përgjigje plotësisht të saktë:

i ujshëm – *përcaktor*

një avull – *kryefjalë*

Nxënësi merr **1 pikë** për një përgjigje të saktë.

29. A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar:

kam pasë - *kam pasur*

B) Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

mënyra - *dëftore*

koha - *e kryer*

forma - *veprore*

30. Skema për vlerësimin e esesë: Votreni – Inteligjenca e së keqes (*Xha Gorio* – HONORE DË BALZAK)

Kërkesa 1.	Nxënësi sqaron rolin e Votrenit në roman. (1 pikë) <i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 2 pikë
Kërkesa 2.	Nxënësi e përshkruan Votrenin: - kush është ai (1 pikë) - përse banon në pension (1 pikë) - tregon për marrëdhëniet e tij me personazhet tjerë. (1 pikë) <i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 4 pikë
Kërkesa 3.	3.1 Nxënësi: - tregon për dimensionin moral të personazhit (1 pikë) - argumenton me shembuj nga teksti (1 pikë) <i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> 3.2 Nxënësi: - sqaron motivin e veprimit të personazhit (1 pikë) - argumenton me shembuj nga teksti (1 pikë)

	<i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 6 pikë
Kërkesa 4.	Nxënësi: - kumton përjetimin e vet të Votrenit (1 pikë) - sqaron përse e përjeton ashtu (1 pikë) <i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 3 pikë

Gjuha dhe forma e tekstit

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura ndërtimore e tekstit
Originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil. 3 pikë	Respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), i kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi , përemrit i vet/ i tij , përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale. 2 pikë	Lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve. 1 pikë	Përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët). 2 pikë
Originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni,	Respektimi i normës drejtshkrimore		

<p>shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale.</p> <p>2 pikë</p>	<p>(shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave <i>r/rr, dh/ll, k/q, s/z, k/g, ç/q, gj/xh, e/ë</i>, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores <i>ë</i>, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <i>j</i>).</p> <p>2 pikë</p> <p>Gjithsej 4 pikë</p>		
<p>Përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil.</p> <p>1 pikë</p>	<p>Respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve <i>për</i> dhe <i>mbi</i>, përemrit <i>i vet/ i tij</i>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit <i>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</i> dhe i përemrave: <i>që, i cili, e cila, të cilët</i> etj.).</p> <p>1 pikë</p> <p>Respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta</p>		<p>Ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit.</p> <p>1 pikë</p>

	(p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë , moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j).		
	1 pikë		
	Gjithsej 2 pikë		

Skema për vlerësimin e esesë: Lumturia është e bukur vetëm derisa e presim

Kërkesa 1.	Nxënësi e komenton fjalinë (1 pikë) dhe paraqet qëndrimin e vet për të. (1 pikë) <i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 3 pikë
Kërkesa 2.	Nxënësi kumton mendimin e vet nëse fati varet prej nesh apo nga njerëzit përreth nesh. (1 pikë) Nxënësi shpjegon mendimin e vet. (1 pikë) <i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 3 pikë
Kërkesa 3.	Nxënësi nga çdo zgjedhje e cekur me argumentim merr nga 1 pikë: - shëndetin me argumentim (1 pikë) - paranë me argumentim (1 pikë) - dashurinë me argumentim (1 pikë) <i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Përveç asaj që ka ofruar shton edhe idenë/idetë e vet/a. (1 pikë) Argumenton idenë/të e vet/a. (1 pikë) <i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i> Gjithsej 7 pikë

Kërkesa 4.	<p>Nxënësi kumton si e kupton ai vargun: <i>Lumturia është e bukur vetëm derisa e presim. (1 pikë)</i></p> <p><i>Për një përgjigje më të plotë dhe me stil 1 pikë.</i></p> <p>Gjithsej 2 pikë</p>
-------------------	--

Gjuha dhe forma e tekstit

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura ndërtimore e tekstit
<p>Originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil.</p> <p>3 pikë</p> <p>Originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale.</p>	<p>Respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), i kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi, përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale.</p> <p>2 pikë</p> <p>Respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe,</p>	<p>Lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve.</p> <p>1 pikë</p>	<p>Përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët).</p> <p>2 pikë</p>

<p>2 pikë</p>	<p>përdorimi i drejtë i shkronjave <i>r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë</i>, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores <i>ë</i>, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <i>j</i>).</p> <p>2 pikë</p> <p>Gjithsej 4 pikë</p>		
<p>Përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil.</p> <p>1 pikë</p>	<p>Respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve <i>për</i> dhe <i>mbi</i>, përemrit <i>i vet/ i tij</i>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit <i>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</i> dhe i përemrave: <i>që, i cili, e cila, të cilët</i> etj.).</p> <p>1 pikë</p> <p>Respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i</p>		<p>Ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit.</p> <p>1 pikë</p>

	<p>shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j).</p> <p>1 pikë</p> <p>Gjithsej 2 pikë</p>		
--	---	--	--